

**VENDIM**  
**Nr. 150, datë 6.3.2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHKETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, të bimëve mjekësore dhe aromatike e të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;

b) mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

ç) mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

**2.1. Bujqësia dhe blegtoria**

a) Pagesa për gjedh të matrikulluar, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë/mëshqerrë dhe deri në 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë viça për fermer/aplikant, me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë gjedhe.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (në vijim ‘SHBB)’”;

b) Pagesa, në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese) për fermer/aplikant, me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

c) Mbarështimi i bletarisë, në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua për fermer/aplikant, me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”;

ç) Pagesa, në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, speca, tranguj, luleshtrydhe).

Masa e përfitimit është në 50% të vlerës totale të faturave tatimore për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se **30 000 mijë lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit.**

**Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje vetëm për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 3 (tre) dynym, ndërsa për aplikantët me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”, sipërfaqja minimale është 1 (një) ha për secilën nga mbjelljet.**

d) Pagesa për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike, në vlerën deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/ha për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”;

dh) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) Implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

## **2.2. Mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi**

2.2.1. Subjektet përfitojnë pagesa në barasvlerë të lehtësimit fiskal për uljen e kostos për naftën, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.2.2. Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës, për të cilën përlllogaritet vlera e përfitimit, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën është çmimi mesatar për muajin dhjetor 2024, i publikuar nga INSTAT-i.

2.2.3. Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. Të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

ii. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave, me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.2.4. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

2.2.5. Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

i. Deri në 100% të vlerës për fermerët/aplikantët, me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

2.2.6. Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet:

i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën e përfituar, e cila është jo më e madhe se 20%;

ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha.

2.2.7. Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfituar më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret sipas nënndarjes “i”, të pikës 2.2.6, ose ka paraqitur dokumente të pasakta, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

2.3. Mbështetje për investime në ferma, në zbatim të pikave 2.3 dhe 3/2, të vendimit nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024”, të ndryshuar.

3. Për masat mbështetëse, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikave 2.1 e 2.2, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, i përcaktuar në këtë vendim.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status “Grup fermerësh” dhe “SHBB”, të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

4. Për aplikimet në masat mbështetëse, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2.1, kryhet kontrolli në terren për verifikimin faktik të numrit të krerëve, në jo më pak se 30% të subjekteve përfituese.

Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfituar më shumë se 20% nga vlera për të cilën plotëson kriteret, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

5. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë e juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**

### ANEKSI 1

#### KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS DHE VLERA QË PËRFITOHET

Nr./Kodi	Kultura bujqësore/ grup-kulturat	Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara litra/ha	Vlera që përfitohet lekë/ha	Specifikime
<b>A</b>	<b>Bimë arash</b>			
A.1	Grupi 1	190	18,582	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	12,714	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjerë njëvjeçarë, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	Grupi 3	90	8,802	Foragjerë shumëvjeçarë, bimë aromatike-mjekësore
<b>B</b>	<b>Drufrutorë</b>			
B.1	Mollë	190	18,582	
B.2	Drufrutorë të tjerë	160	15,648	Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta
B.3	Arrorë	140	13,692	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara)
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrorë	170	16,626	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore
<b>C</b>	<b>Perime</b>			
C.1	Perime fushe sezoni 1	150	14,670	Të gjitha llojet e perimeve, përfshi shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime serre, sezoni 1	170	16,626	Të gjitha llojet e perimeve, përfshi shalqi, pjepër, luleshtrydhe

**\* Barasolera e lehtësimit fiskal për litër naftë:**

- Akciza 38.8 lekë/L
- Taksa e qarkullimit 27 lekë/L
- Taksa e karbonit 3 lekë/L
- TVSH (20%) 29 lekë/L<sup>1</sup>

-----  
**TOTAL 97.8 lekë/L**

<sup>1</sup> Çmim referencë për naftën është marrë çmimi mesatar prej 174.1 lekësh/litër me TVSH, i publikuar nga INSTAT-i për muajin dhjetor 2024.